

I THEMELIMIT TË SHOQËRISË PRIVATE TREGËTARE "QERAMIKA E JUGUT"

( sh p k )



Sot më datën 20.10.1994 në Përmet, unë, Përparim Skënderi i biri i Njeziut i vitlindjes 1944, lindur në Përmet e banues në Lushnje, me dëshirën time mora vëndim për krijimin e shoqërisë tregëtare me emrin "Qeramika e Jugut" (shpk) me përgjegjësi të kufizuar qëndra e së cilës është në Përmet por me kalimin e kohës mund të ndryshoj shtetësi e saj.

Veprimtaria e shoqërisë "që po krijoj do të konsistoj në fushën e prodhimit e tregëtimit të tyllave të të gjithalloeve, prodhim e tregëtim tjegullësh të të gjitha llojeve, prodhim qeramike, hidrosanitare të të gjitha llojeve, prodhim materiale sh ndërtimi si dhe ndërtim objektësh të ndryshme, tregëtim materiale ndërtimi me shumicë e pakicë, aktivitete biznesi, etj. Këtë aktivitet do ta ushtroj aktualisht si ortak e administrator i vetëm, pa pjesëmarrës të tjerë sot për sot, me një kapital fillestar 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Këtë akt themelimi e mbështes në ligjin nr.7512 datë 10.8.1991 dhe nr.7638 datë 19.11.1992 për shoqëritë tregëtare dhe mbasi të regjistrohesh si person juridik i kësaj shoqërie tregëtare në organet kompetente (Gjykata e Rrethit Tiranë dhe përfundimisht në zyrën përkatëse tatimore) do të zhvilloj veprimtari në private sipas objektit të shënuar në statut dhe të përcaktuar në vëndimin përkatës të gjykatës si person juridik.

Në aktivitetin tim në këtë shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (shpk) do të përmbahem statutit të hartuar për këtë qëllim dhe do të respektoj si dispozitat ligjore që janë në fuqi dhe ato që do të dalin më vonë për veprimtari në private të shoqërive prodhuese e tregëtare.

Ky akt themelimi u redaktua në vëpkopje nga të: cilat njëra e mban gjykata e rrethit Tiranë, njëra nga zyra e noterisë, njëra do dorëzohet në zyrën e tatimeve dhe një e mban pronari themelues i shoqërisë

Akti i themelimit nënshkruhet nga unë themeluesi i kësaj shoqërie (shpk)

Ortaku i vetëm i themelimit të shoqërisë private tregëtare "Qeramika e Jugut"

Përparim Skënderi

# STATUTI

## I SHOQËRISË PRIVATE TREGËTARE ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR (SHPK) "QERAMIKA E JUGUT"



Në mbështetje të ligjit 7512 datë 10.8.1991 dhe të Ligjit nr.7638 datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregëtare" unë i quajtori Përparim Skënderi si themelues i shoqërisë private tregëtare shpk "Qeramika e Jugut" sot në datën 20.10.1994, duke patur zotësinë e plotë juridike për të vepruar shpall për sa vijon :

"Formimin e shoqërisë private tregëtare (shpk) Qeramika e Jugut" me qëndër në qytetin e Përmetit".

### FORMIMI

#### NENI I

Formohet shoqëria private tregëtare "Qeramika e Jugut (shpk) me themelues Përparim Skënderi, i biri i Njaziut, i vitlindjes 1944, lindur në Përmet e banues në Lushnje.

### QENDRA E SHOQËRISË

#### NENI II

Shoqëria private tregëtare (shpk) "Qeramika e Jugut" e ka qendrën e saj në qytetin e Përmetit, por me kalimin e kohës mund të ndërroj vendqendrimin e saj, brenda këtij qyteti ose të hap degë të tjera në qytetet e tjera të Shqipërisë.

### KOHËZGJATJA E VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

#### NENI 3

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është pa afat dhe mbi 10 vjet por shoqëria mund të shpërbëhet në çdo kohë dhe për çdo shkak.

### OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë "Qeramika e Jugut" është :

Prodhim e tregëtim tullash të të gjitha llojeve, prodhim e tregëtim tjegullash të të gjitha llojeve, prodhim qeramike, hidrosanitare të të gjitha llojeve, prodhim materiale ndërtimi si dhe ndërtim objektesh të ndryshme, tregëti materiale ndërtimi me shumicë e pakicë, aktivitete biznesi.

### KAPITALI I SHOQËRISË

#### NENI 5

Kapitali i shoqërisë si fillim është 100.000 (njëqind mijë) lekë kontributi i vetëm themeluesit të shoqërisë, zotit Përparim Skënderi dhe vetëm ai është disponuesi i këtij kapitali. Kapitali i kësaj shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (shpk) do të shtohet ose do pakësohet me kalimin e

sipas vendimit që do të mari ortakut i vetëm dhe themeluesi



## DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI

### N E N I 6

Shoqëria private tregëtare "Qeramika e Jugut" deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave që përmban ky statut dhe të legjislationit shqiptar në fuqi. Administratori i kësaj shoqërie është themeluesi dhe ortakut i vetëm i saj, zoti Përparim Skënderi. Në rast nevojë për zhvillimin e mëtejshëm të veprimtarisë ekonomiko-financiare mund të emëroj administrator të tjerë në qëndër të shoqërisë (Përmet) si dhe në degët e saj. Gjithashtu ai punëson punëtor sipas nenit 4 të këtij statuti, duke respektuar ligjin për mardhëniet e punës.

### N E N I 7

Administratorët e emëruar nga ortakut dhe themeluesi i kësaj shoqërie nuk mund të mari cilësitë e ortakut të vetëm të saj dhe es mund të ushtroj aktivitete kontraktuese të çdo llëji për llogari të tyre ose të të tretëve përveç rasteve të autorizuar nga ortakut i vetëm i shoqërisë. Për çdo shkelje të administratorët ose të punësuarit largohen nga puna dhe përgjigjen për çdo dëmtim.

### N E N I 8

Të gjitha shpenzimet e nevojshme për mbajtjen e të punësuarve përballohen nga vetë shoqëria private tregëtare "Qeramika e Jugut" (shpk).

## SEKRETI I PUNËS

### N E N I 9

Të gjithë të emëruarit në shoqëri janë të detyruar të ruajnë sekre in e punës të shoqërisë. Sekret pune paraqet shkresat, materialet, aktet të cilat me ligj të veçantë dhe me vendime të nxjerra nga ortakut i vetëm i shoqërisë përbëjnë sekret pune. Detyrat mbi ruajtjen e sekretit të punës nga të punësuarit vazhdojnë edhe pas largimit të tyre nga shoqëria.

## BILANÇI DHE TË ARDHURAT

### N E N I 10

Veprimet ekonomike dhe financiare të shoqërisë "Qeramika e Jugut" mbyllen më 31.12.1990 çdo viti, përveç urdhërave të veçanta që jep ortakut i vetëm i shoqërisë për këtë qëllim. Në fund të periudhës ushtrimore (muajore dhe tre muajore) shoqëria dhe administratori nxjerrin bilancin kontabël me rezumatit ekonomik fitim ose humbje bazuar në ligjet në fuqi dhe në rregullat e kontabilitetit. Bilançi kontabël miratohet dhe nënshkruhet nga ortakut e themeluesi i shoqërisë.



N E N I 11

Të ardhurat neto pas veçimit të fondeve të akumulimit dhe të pagesë së detyrimeve fiskale i mbeten për përdorim ortakut të vetëm të shoqërisë ose bashkëpronarëve, nëse do të ketë të tillë. Pjesë tjetër ajo e fitimit neto, që i përket ortakut të vetëm të shoqërisë në Shqipëri (apo anëtarëve të saj) mund të transferohen ligjërisht dhe lirisht jashtë shtetit, pa kufizim, bazuar në ligjin 7594, datë 4.8.92

SHPËRBERJA E SHOQËRISË

N E N I 12

Shoqëria mund të shpërndahej në çdo kohë dhe për çdo shkak. Ortaku i vetëm i shoqërisë vëndos mbi mënyrën e likuidimit dhe caktton një ose më shumë likuidator duke ua përcaktuar detyrat. Administratorët e emëruar prej tij janë përgjegjës për ruajtjen e pasurisë së shoqërisë për deri sa ajo t'u dorëzohet personave fizik e juridik duke likuiduar në rradhë të parë detyrimet ndaj personave të tre të që mund të ketë shoqëria.

N E N I 13

Shoqëria private tregëtare "Qeramika e Jugut" ka numrin e llogarisë rrjedhëse në regjistruar në Bankën e Shtetit Shqiptar Përmes.

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

N E N I 14

Shoqëria private tregëtare "Qeramika e Jugut" ka vulën e saj me mbishkrimin: "Shoqëria private tregëtare (shpk) Qeramika e Jugut Përmes (Albania).

N E N I 15

Përse nuk është shprehur në këtë statut i referohet çdo ligji të veçantë përkatës dhe legjislacionit shqiptar përkatës, veçanërisht ligjit për shoqëritë tregëtare nr.7638 datë 19.11.1992 si dhe ligjeve të tjera që do të shpallen për këtë qëllim.

N E N I 16

Ky statut redaktohet në 4 kopje nga të cilët njëra e mban zyra e noterisë për të kryer veprimin noterial, njëra e mban gjykatën e rrethit Tiranë për të bërë regjistrimin e shoqërisë si person juridik, një kopje i dorëzohet zyrës tatimore së bashku me dokumentet e tjera përkatëse, ndërsa kopja e fundit i mbetet shoqërisë si pjesë e dokumentacionit të saj.

Statuti nënshkruhet rregullisht nga ortaku i vetëm dhe themeluesi i kësaj shoqërie.

Ortaku i vetëm dhe administrator i shoqërisë private tregëtare "Qeramika e Jugut" (shpk) Përparim Skënderi